



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Qershor 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Qershor 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin qershor të vitit 2023)**

Vlerësohen të arriturat, kërkohet përkushtim
sistematik për trajtimin e lëndëve të
korrupsionit dhe të krimeve ekonomike

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe
Krimeve Ekonomike ka vizituar Prokurorinë Themelore
të Prizren, ku janë pritur nga Zëvendëskryeprokurorja
e kësaj prokurorie.



Rrjedhimisht, qëllimi i kësaj vizite ishte shqyrtimi i
raportit tremujor për periudhën janar-mars 2023 dhe
diskutimi për sfidat e trajtimit të lëndëve të
korrupsionit dhe të krimeve ekonomike që hyjnë në
kuadër të kësaj prokurorie.

Gjatë vizitës u vlerësuan të arriturat e deritashme në
këtë prokurori, me ç'rast është diskutuar lidhur me
procesin e kryerjes së lëndëve të korrupsionit dhe të
krimeve ekonomike, duke kërkuar përkushtim të
mëtutjeshëm për trajtimin e këtyre lëndëve që i
përkasin vitit 2022 edhe 2023.

Mbahet takimi i dytë i Grupit punues për
vlerësimin e sistemit disiplinor të gjyqtarëve
dhe prokurorëve

Grupi punues për vlerësimin e sistemit disiplinor të
gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka mbajtur takimin e tij
të dytë, në të cilin morën pjesë përfaqësuesit e
Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të
Kosovës, Ambasadës së SHBA-së dhe të BE-së.



Në takimin e sotëm është diskutuar për ligjet dhe aktet nënligjore, për të cilat kërkohet identifikimi i nevojshëm për ndryshime dhe plotësime në bazë të rekomandimeve të dhëna. Me këtë rast është bërë edhe ndarja e nëngrupeve punuese, të cilat do të përbëhen nga përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, detyrë e të cilave është hartimi i raporteve lidhur me identifikimin për ndryshime dhe plotësime të këtij legjislacioni.

Gjithashtu, gjatë diskutimeve, u tha se përfaqësuesit e Ambasadës Amerikanë dhe përfaqësuesit e BE-së do të ofrojnë mbështetjen e tyre, ndërsa në takimin e ardhshëm do të prezantohen dy raportet e hartuara nga përfaqësuesit e KPK-së dhe KGJK-së, nga të cilat do të hartohet raporti final.

Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizituan Prokurorinë Themelore në Gjilan

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore në Gjilan, ku janë pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie.



Kjo vizitë është zhvilluar në kuadër të monitorimit të rregullt, me ç'rast, ndër të tjera, është shqyrtuar raporti tremujor për periudhën janar-mars 2023 dhe ka pasur diskutime për sfidat e trajtimit të lëndëve të

korrupsionit dhe të krimeve ekonomike në këtë prokurori.

Anëtarët e këtij Komisioni, theksuan gjatë diskutimeve të tyre se në këtë prokurori janë shënuar rezultate të konsiderueshme në trajtimin e këtyre lëndëve dhe se përkundrejt këtyre vlerësimeve pozitive, kërkohet që të vazhdojë ky intensitet dhe të ketë sa më shumë përkushtim në të ardhmen për trajtimin e këtyre lëndëve.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit të për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative i KPK-së ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë, përveç anëtarëve të Komisionit, edhe përfaqësuesja e Ambasadës së SHBA-së dhe përfaqësuesi i EUKOJUST-it.



Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, në mënyrë në kjo rregullore të jetë në përputhje me këtë ligj, që ka pësuar disa ndryshime ligjore sa u përket kritereve për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve të prokurorive dhe zëvendëskryeprokurorëve.

Gjatë këtij takimi, pjesëmarrësit dhanë komentet e tyre, me ç'rast ato që kanë pasur relevancë janë inkorporuar në draftin përfundimtar të kësaj rregulloreje.

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së shqyrtoi kërkesën buxhetore për vitin 2024 dhe vlerësimet e hershme për 2025-2026

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) mbajti takimin e radhës, në të cilin përveç anëtarëve, mori pjesë edhe

Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së dhe udhëheqëset e njësive për buxhet dhe financa.



Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i kërkesës buxhetore për vitin 2024 dhe vlerësimet e hershme për 2025-2026 për të gjitha programet buxhetore të KPK-së dhe kategoritë ekonomike të buxhetit.

Në këtë kuadër, u diskutuan planifikimet buxhetore me fokus nevojat për staf dhe buxhet shtesë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe mallrave dhe shërbimeve sipas kërkesave të prokurorive dhe njësive tjera përgjegjësisë të KPK-së.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, e njëjta do të rekomandohet për aprovim në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët dhe udhëheqësit e njësive organizative të Sekretariatit të KPK-së.



Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për mbajtjen e punëtorisë me administratorët e prokurorive themelore për të diskutuar temat dhe pjesëmarrësit e punëtorisë, zbatimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), raportet statistikore, sigurinë e objekteve dhe resurset.

Në takimin e sotëm u theksua se pas përfundimit të punëtorisë do të ketë funksionalizim më të madh të zbatimit të SMIL-it në sistemin prokurorial dhe personat përgjegjës do të jenë në komunikim të rregullt me menaxhmentin e prokurorive të vendit për t'i njoftuar lidhur me mënyrat adekuate të përdorimit të SMIL-it, gjë që përbën edhe ngritjen e efikasitetit në punë dhe rritjen e transparencës institucionale.

Prokuroria Themelore në Prishtinë vizitohet nga anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizituan Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ku janë pritur nga Kryeprokurori dhe Zëvendëskryeprokurori i kësaj prokurorie, si dhe prokurorët e Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion.



Me këtë rast është shqyrtuar raporti tremujor për periudhën janar-mars 2023 dhe janë zhvilluar diskutime për sfidat e trajtimit të lëndëve të korrupsionit dhe të krimeve ekonomike në këtë prokurori.

Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, theksuan se përkundrejt rezultateve të shënuara në trajtimin e këtyre lëndëve, në të ardhmen nevojitet që të ketë intensitet dhe përkushtim të shtuar për trajtimin e këtyre lëndëve.

Mbahet takimi i 231-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, mbajti takimin e radhës, të 231-tin me radhë.



Fillimisht, në takimin e sotëm është themeluar Paneli hetimor për rastin disiplinor ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe janë miratuar Rregullorja për Komisionin Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve dhe Rregullore për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Anëtarët e KPK-së, gjithashtu, miratuan Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Hartimin e Akteve Normative të KPK-së, kurse për takimin e ardhshëm është shtyrë Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, lidhur me Kërkesën buxhetore të sistemit prokurorial për vitin 2024 referuar qarkores së parë buxhetore dhe vlerësimeve të hershme 2025 dhe 2026, para anëtarëve të KPK-së ka raportuar Udhëheqësja e Departamentit për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, kërkesë kjo, e cila është aprovuar me rekomandime.

Këshilli Prokurorial mori vendim për të dërguar propozimin tek Presidentja e vendit për t'i liruar nga detyra dy prokurorë me rastin e arritjes së moshës së pensionimit gjatë muajit korrik 2023, kurse në vijim është caktuar Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së deri në zgjedhjen e drejtorit, por jo më gjatë sesa tre muaj.

Në fund të këtij takimi është mbajtur një seancë disiplinore ndaj një prokurori të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse vendimi përkatës do të bëhet publik siç parashihet me ligj.

Urimi i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, me rastin e Festës së Kurban Bajramit

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, me rastin e Festës së Kurban Bajramit, ju ka dërguar urimet më të përzemërta të gjithë besimtarëve myslimanë me rastin e Festës së Kurban Bajramit, duke uruar që kjo festë e shenjtë t'u sjellë paqe, harmoni dhe prosperitet në familje.



Një delegacion i lartë i sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës viziton institucionet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë

Një delegacion i lartë i sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, i përbërë nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Zëvendëskryesuesi i KPK-së, Veton Shabani, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, anëtarët e Këshillit Prokurorial dhe Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, janë duke qëndruar për një vizitë zyrtare në institucionet e larta prokuroriale të Republikës së Shqipërisë.

Qëllimi i kësaj vizite është diskutimi për fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ndërshtetërore, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe për gjetjen e formave dhe mënyrave të avancimit të këtij bashkëpunimi në funksion të luftimit të kriminalitetit ndërshtetëror, problematikave të përbashkëta të evidentuara nga ana e strukturave të

të dyja shteteve dhe aspekte të tjera thelbësore që shërbejnë për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të prokurorëve, si dhe për tejkalimin i sfidave që ndërlidhen me veprimtarinë e përgjithshme të sistemit prokurorial dhe të drejtësisë në përgjithësi.



Në kuadër të kësaj vizite, në ditën e parë, delegacioni i lartë i institucioneve të sistemit prokurorial të Kosovës është pritur në takim nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Shqipërisë, Alfred Balla, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Naureda Llagami dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani, të cilët kanë falënderuar delegacionin kosovar për vizitën e tyre, me ç'rast i kanë njoftuar për proceset e përgjithshme të funksionimit kushtetues e ligjor dhe për aktivitetet e këtyre institucioneve të shtetit shqiptar.

Nga ana tjetër, Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, në emër të delegacionit kosovar, ka shprehur falënderim për ftesën dhe ofrimin e bashkëpunimit ndërinstucional, me qëllim të shkëmbimit të përvojave që ndikojnë në ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të ndjekjes së krimeve të ndryshme, profesionalizmit, menaxhimit dhe administrimit të sistemeve prokuroriale, duke potencuar nevojën e përbashkët të vazhimit të këtij bashkëpunimi për avancimin e praktikave më të mira në kuadër të sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës.



Me këtë rast, të dyja palët, gjatë diskutimeve, kanë vlerësuar në mënyrë të veçantë përcaktimin e nevojave specifike për një bashkëpunim strategjik për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, korrupsionin, krimet ekonomike, pastrimin e parave, terrorizmin dhe krimin kibernetik, si dhe për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut përmes zbatimit të standardeve më të larta profesionale.

Delegacioni i sistemit prokurorial nga Kosova do të ketë edhe gjatë ditës së nesërme takime të ngjeshura me drejtuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Prokurorisë së Tiranës, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Programit OPDAT.

[Përfaqësuesit e KPK-së dhe institucioneve të Prokurorit të Shtetit të Kosovës priten në takim nga Kryeprokurori i Përgjithshëm dhe Kryetarja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të Shqipërisë](#)

Me ftesë të institucioneve të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuesit e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, në përbërje nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Zëvendëskryesuesi i KPK-së, Veton Shabani, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, anëtarët e Këshillit Prokurorial dhe Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, janë pritur sot në takim nga Prokurori i Përgjithshëm, Olsian Çela dhe Kryetarja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Pamela Qirko.

Më këtë rast, përfaqësuesit e sistemit prokurorial nga bashkëbiseduesit janë njoftuar për së afërmi për strukturën, objektivat dhe angazhimet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe për procesin e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, qasjen reformuese dhe sfidat me të cilat ballafaqohet këto dy institucione.



Në këtë kontekst, me theks të veçantë është diskutuar për vlerësimin e prokurorëve dhe masat disiplinore për prokurorë, zhvillimin e aftësive organizative, veçanërisht në fushën e bërjes së politikave strategjike prokuroriale, mekanizmave koordinues, zhvillimin e karrierës së prokurorëve, përgjegjësinë e prokurorëve dhe llogaridhënien e tyre, si dhe për mënyrën dhe metodat që janë zbatuar gjatë procesit të vetingut të prokurorëve dhe vlerësimit dhe rivlerësimit kalimtar të tyre bazuar në legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar.

Po ashtu është biseduar gjerësisht edhe për gjetjen e formave të intensifikimit të bashkëpunimit, duke shprehur gatishmërinë e dyanshme për vazhdimin e shkëmbimit të përvojave në shërbim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të prokurorëve të të dyja vendeve, duke theksuar se mbeten të përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit në kuadrin e programeve dhe të reformave në mes sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës dhe sistemit prokurorial të Republikës së Shqipërisë, me anë të zbatimit të praktikave më të mira të përbashkëta lidhur me luftimin e krimit dhe veprave penale dhe proceseve reformuese, me qëllim që të arrihen rezultate pozitive dhe efikase.